VENDIM
Nr.25, datë 26.3.2009

PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE (PARQET EOLIK VISU DHE TERPAN) TË SHOQËRISË "ALB WIND ENERGY) SHPK, SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", neni 9, pika 1, dhe 2, germa (a), Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 26.3.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "ALB WIND ENERGY" sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhuese (parqet eolik Visu dhe Terpan), si burime të rinovueshme energjie,

konstatoi se:

- Me vendimin nr.15, datë 6.3.2009, Bordi i Komisionerëve ka filluar procedurat e shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë "ALB WIND ENERGY" sh.p.k. për kualifikimin e impianteve prodhues (parqet eolik Visu dhe Terpan) si burime të rinovueshme energjie;
- Dokumentacioni bashkëlidhur aplikimit është në përputhje me kërkesat e neneve 6 dhe 7, pika 1, 2 dhe 3 të Rregullores së Procedurave të Certifikimit të Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Burimet e Rinovueshme.

Për gjitha sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1.Të kualifikojë impiantet prodhuese (parqet eolik Visu dhe Terpan) të shoqërisë "ALB WIND ENERGY" sh.p.k., si burim i rinovueshëm energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta